

Legal Newsletter Albania

September 2026

Law No. 78/2026 "On the Statute of the European Company (SE)"

On 23 July 2026, the Assembly of the Republic of Albania adopted Law No. 78/2026 "On the Statute of the European Company (SE)", fully approximated with Council Regulation (EC) No. 2157/2001, which for the first time enables the incorporation and operation of a European Company (Societas Europea, SE) with registered office in Albania. The SE is an EU-aligned joint-stock vehicle with separate legal personality, minimum subscribed capital of EUR 120,000, and the ability to be formed by merger, as a holding, or by conversion of a joint-stock company. The SE is registered with the National Business Center (QKB).

Key features include a choice between one-tier (board of administration) and two-tier (supervisory council and administrators) governance with a maximum six-year term for members of SE organs, the ability to transfer the registered office across EU Member States without liquidation or re-incorporation, protection of dissenting shareholders through cash compensation and of creditors through the right to request security, and mandatory employee-involvement arrangements as a precondition for registration.

Ligji Nr. 78/2026 "Për statutin e shoqërisë evropiane (SE) "

Më 23 korrik 2026, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 78/2026 “Për statutin e shoqërisë evropiane (SE)”. I përafruar plotësisht me Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 2157/2001, ligji mundëson për herë të parë themelimin dhe ushtrimin e veprimtarisë në Shqipëri të një Shoqërie Evropiane (Societas Europaea, ose SE) me seli të regjistruar në vend. SE-ja është një shoqëri aksionare evropiane me personalitet juridik të veçantë, kapital të nënshkruar minimal prej 120 000 eurosh dhe mund të krijohet nëpërmjet bashkimit, si shoqëri holding ose nëpërmjet shndërrimit të një shoqërie aksionare. Ajo regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

Ndër veçoritë kryesore janë mundësia e zgjedhjes ndërmjet sistemit një-nivelësh të qeverisjes, me këshill administrimi, dhe sistemit dy-nivelësh, me këshill mbikëqyrës dhe administratorë. Mandati i anëtarëve të organeve të SE-së mund të jetë deri në gjashtë vjet. Ligji mundëson gjithashtu transferimin e selisë së regjistruar ndërmjet shteteve anëtare të BE-së pa likuidim ose rithemelim, mbron aksionarët kundërshtues përmes kompensimit në para dhe u jep kreditorëve të drejtën të kërkojnë garanci. Marrëveshjet për përfshirjen e punëmarrësve janë kusht paraprak për regjistrimin.

©2026 PwC. All rights reserved. PwC refers to the PwC network and/or one or more of its member firms, each of which is a separate legal entity. Please see www.pwc.com/structure for details. This content is for general information purposes only, and should not be used as a substitute for consultation with professional advisers.

Together with the newly introduced European Cooperative Society (SHEB/SCE) and the European Economic Interest Grouping (EEIG), the SE completes a trio of EU-aligned corporate vehicles now available under Albanian law, marking a significant step in bringing the national framework closer to the EU acquis on cross-border business organizations ahead of accession. For the first time, Albanian joint-stock companies, cooperatives, and groups of businesses have access to recognized European legal forms that enable cross-border mergers, group restructurings, re-domiciliation within the EU, and joint cooperation with EU partners under a single legal identity - opening Albania's corporate landscape to the broader European market.

Së bashku me Shoqërinë Evropiane të Bashkëpunimit (SHEB/SCE) dhe Grupimin Evropian të Interesit Ekonomik (EEIG), të prezantuara rishtazi, SE-ja plotëson një grup prej tri formash shoqërore të përafruara me BE-në, tashmë të disponueshme sipas legjislacionit shqiptar. Kjo përbën një hap të rëndësishëm drejt përafrimit të kuadrit kombëtar me acquis-në e BE-së për organizatat e biznesit me veprimtari ndërkufitare, në prag të anëtarësimit. Shoqëritë aksionare, kooperativat dhe grupimet e bizneseve shqiptare mund të përdorin forma juridike evropiane të njohura për bashkime ndërkufitare, ristrukturime grupesh, transferim të selisë brenda BE-së dhe bashkëpunim me partnerë të BE-së nën një identitet të vetëm juridik, duke e lidhur më ngushtë mjedisin shqiptar të biznesit me tregun më të gjerë evropian.



Law No. 76/2026 “On the Statute of the European Company (SE)”

On 23 July 2026, the Assembly of the Republic of Albania adopted Law No. 76/2026 "On European Economic Interest Groupings", fully aligned with Council Regulation (EEC) No. 2137/85, which for the first time enables the formation of a European Economic Interest Grouping (EEIG) with official address in Albania. The EEIG is an EU-aligned cross-border cooperation vehicle with separate legal personality, designed to facilitate the economic activities of its members - natural or legal persons established in Albania or in an EU Member State - without pursuing profits for itself, and registered with the National Business Center (QKB).

Key features include a minimum of two members from different Member States (or Albania and a Member State), a cap of 20 members and 500 employees, unlimited joint and several liability of members, direct taxation of profits in the members' hands, and the possibility to transfer the official address within the EU and/or Albania.

Ligji Nr. 76/2026 “Për grupimet ekonomike me interes evropian”

Më 23 korrik 2026, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 76/2026 “Për grupimet evropiane të interesit ekonomik”, i përafruar plotësisht me Rregulloren e Këshillit (KEE) nr. 2137/85. Ligji mundëson për herë të parë krijimin në Shqipëri të një Grupimi Evropian të Interesit Ekonomik (EEIG) me adresë zyrtare në vend. EEIG-ja është një formë bashkëpunimi ndërkufitar e përafruar me BE-në, me personalitet juridik të veçantë, që synon të lehtësojë veprimtarinë ekonomike të anëtarëve të saj—persona fizikë ose juridikë të themeluar në Shqipëri ose në një shtet anëtar të BE-së—pa synuar realizimin e fitimit për vete. Grupimi regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

Ndër veçoritë kryesore janë kërkesa për të paktën dy anëtarë nga shtete të ndryshme anëtare (ose nga Shqipëria dhe një shtet anëtar), kufiri maksimal prej 20 anëtarësh dhe 500 punonjësish, përgjegjësia e pakufizuar solidare e anëtarëve, tatimi i drejtpërdrejtë i fitimeve në nivelin e anëtarëve dhe mundësia për të transferuar adresën zyrtare brenda BE-së dhe/ose Shqipërisë.

©2026 PwC. All rights reserved. PwC refers to the PwC network and/or one or more of its member firms, each of which is a separate legal entity. Please see www.pwc.com/structure for details. This content is for general information purposes only, and should not be used as a substitute for consultation with professional advisers.

Law No. 77/2026 “On European Cooperative Societies (SHEB)

On 23 July 2026, the Assembly of the Republic of Albania adopted Law No. 77/2026 "On European Cooperative Societies (SHEB)", fully aligned with Council Regulation (EC) No. 1435/2003, which for the first time enables the formation of a European Cooperative Society (SHEB/SCE) with registered office in Albania. The SHEB is an EU-aligned cooperative vehicle with separate legal personality, whose principal purpose is to meet the needs and develop the economic and social activities of its members - natural or legal persons established in Albania or in an EU Member State - through variable capital and membership, with members' liability limited to their subscribed contribution unless the statute provides otherwise, and registered with the National Business Center (QKB).

Key features include a minimum subscribed capital of EUR 30,000 (or lek equivalent); formation always with an Albania-and-EU-Member-State cross-border element - by founders (at least five where natural or mixed persons), by legal persons, by a merger of cooperatives, or by conversion of an existing cooperative; a choice between one-tier and two-tier governance with a six-year maximum term, one member/one vote (with investor members capped at 25% of voting rights), and the possibility to transfer the registered office within the EU without liquidation or or re-incorporation.

Ligji Nr. 77/2026 “Për shoqëritë evropiane të bashkëpunimit (SHEB)”

Më 23 korrik 2026, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 77/2026 “Për shoqëritë evropiane të bashkëpunimit (SHEB)”, i përafruar plotësisht me Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1435/2003. Ligji mundëson për herë të parë krijimin e një Shoqërie Evropiane të Bashkëpunimit (SHEB/SCE) me seli të regjistruar në Shqipëri. SHEB-ja është një formë shoqërie kooperative e përafruar me BE-në dhe me personalitet juridik të veçantë, që ka si qëllim kryesor përmbushjen e nevojave dhe zhvillimin e veprimtarive ekonomike e shoqërore të anëtarëve të saj, persona fizikë ose juridikë të themeluar në Shqipëri ose në një shtet anëtar të BE-së, përmes kapitalit dhe anëtarësisë së ndryshueshme. Përgjegjësia e anëtarëve kufizohet në kontributin e nënshkruar prej tyre, përveç rasteve kur statuti parashikon ndryshe. SHEB-ja regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

Ndër veçoritë kryesore janë kapitali minimal i nënshkruar prej 30 000 eurosh ose kundërvlera në lekë dhe kërkesa që themelimi të ketë gjithmonë element ndërkufitar ndërmjet Shqipërisë dhe një shteti anëtar të BE-së. Shoqëria mund të krijohet nga themelues, të paktën pesë, kur bëhet fjalë për persona fizikë ose një grup të përzi, nga persona juridikë, nëpërmjet bashkimit të kooperativave ose shndërrimit të një kooperative ekzistuese. Parashikohet zgjedhja ndërmjet qeverisjes një-nivelëshe dhe dy-nivelëshe, me mandat maksimal gjashtëvjeçar, parimi “një anëtar, një votë” (ku të drejtat e votës së anëtarëve investitorë kufizohen në 25%) dhe mundësia e transferimit të selisë së regjistruar brenda BE-së pa likuidim ose rithemelim.



©2026 PwC. All rights reserved. PwC refers to the PwC network and/or one or more of its member firms, each of which is a separate legal entity. Please see www.pwc.com/structure for details. This content is for general information purposes only, and should not be used as a substitute for consultation with professional advisers.



Contact us

PwC Albania

Address: Str. “Ibrahim Rugova”, Sky Tower, 9/1 Tirana, Albania
Telephone: +(355) 42 242 254
Email: al_pwc_albania@pwc.com
Web: www.pwc.com/al